

VENDIM
Nr. 393, datë 29.6.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 14 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në Bordin e Akreditimit merr pjesë edhe një student, në rolin e vëzhguesit, përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Studentëve.”.

b) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Mbledhja e Bordit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Vendimet e Bordit merren me shumicë prej $\frac{3}{4}$ të anëtarëve të pranishëm.”.

c) Pika 26 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“26. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Akreditimit paguhen për çdo pjesëmarrje në mbledhje. Për çdo vit kalendarik zhvillohen 12 (dymbëdhjetë) mbledhje. Nëse është e nevojshme, Bordi mund të mbledhet deri në 3 (tri) herë të tjera, brenda të njëjtit vit kalendarik, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

ç) Pika 27 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“27. Masa e shpërblimit për çdo mbledhje të jetë, si më poshtë vijon:

a) Anëtarët me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

b) Anëtarët me rezidencë të përhershme jashtë Republikës së Shqipërisë, në masën 600 (gjashtëqind) euro;

c) Kryetari, në varësi të rezidencës së tij të përhershme, në masën 30% më shumë se anëtarët e Bordit.”.

d) Në paragrafin e parë, të pikës 2, të shtojcës 2, bashkëlidhur vendimit, pas fjalëve “... në IAL-të publike ...” shtohen “... dhe jopublike ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku